



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

**MINISTRIA PËR DIALOG**

---

# Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit

*/periudha 2014 - 2018/*

**Edita Tahiri, Ministre për dialog**

Prishtinë, 15 janar 2015

**PËRMBAJTA:**

1. DIALOGU I BRUKSELIT PËR PAQE, FQINJËSI DHE INTEGRIME EURO-ATLANTIKE.....	3
1.1. Dialogu i Brukselit në dobi të shtetit të Kosovës.....	4
1.2. Njohja e ndërsjellë mes dy shteteve sjellë paqe të qëndrueshme në rajon.....	5
1.3. Marrëveshjet e Brukselit dhe përfitimet për Kosovën.....	6
1.4. Procesi i zbatimit të marrëveshjeve.....	7
1.5. Objektivi kryesor për periudhën vijuese – njohja e ndërsjellë mes dy shteteve.....	8
1.6. Roli i faktorit ndërkombëtar garanci për sukses.....	9
2. DIALOGU DHE DIPLOMACIA PËR FUQIZIMIN NDËRKOMBËTAR TË KOSOVËS.....	9
3. STRATEGJIA E DIALOGUT.....	10
4. PARIMET THEMELORE DHE PARIMET E PANEGOCIUESHME TË DIALOGUT.....	10
4.1. Parimet themelore.....	10
4.2. Parimet e panegociueshme / vijat e kuqe.....	11
5. FUSHËVEPRIMTARIA E DIALOGUT TË BRUKSELIT.....	12
6. KATËR SHTYLLAT E PROCESIT NEGOCIATOR.....	14
7. SHTIMI I KAPACITETEVE.....	16
8. BUXHETI PËR DIALOG.....	16
9. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA.....	17

## **1. DIALOGU I BRUKSELIT PËR PAQE, FQINJËSI DHE INTEGRIME EURO-ATLANTIKE**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të prioriteteve të politikës së jashtme, do të vazhdoj të jetë e përkushtuar në Dialogun e Brukselit për fqinjësinë e mirë dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë si dy shtete të pavarura dhe sovrane, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se Dialogu i Brukselit është një angazhim ndërkombëtar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe parimet themelore të saj, ku ndër tjerash thuhet “se shteti i Kosovës zotohet të kontribuojë në stabilitetin e rajonit dhe të mbarë kontinentit evropian, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje”

Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se angazhimi në Dialogun e Brukselit kontribuon për përmirësimin e jetës së qytetarëve, forcimin e sovranitetit shtetëror të Kosovës dhe avancimin e vizionit euro-atlantik të Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian, NATO, OKB dhe institucione tjera relevante ndërkombëtare.

Qeveria vlerëson se angazhimi në Dialogun e Brukselit dëshmon përkushtimin e shtetit tonë për paqe dhe stabilitet në rajon si dhe kontribuon drejtpërsëdrejti për plotësimin e standardeve evropiane për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian duke marrë parasysh se fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi rajonal janë ndër kriteret kryesore për anëtarësimin e vendeve në Bashkimin Evropian.

Qeveria zotohet se do të çojë përpara qëllimet e shtetit tonë në këtë dialogë mbi një platformë të qartë objektivash dhe parimesh mbi mbrojtjen e interesave nacionale, mbrojtjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektimin e Rezolutave të Kuvendit të Kosovës dhe avancimin e synimeve tona strategjike për integritime euro-atlantike.

Qeveria do të vazhdoj këtë një qasje serioze dhe konstruktive në Dialogun e Brukselit në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë kushtetuese të saj duke qenë në bashkëpunim të plotë me institucionet e tjera të shtetit, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka pranuar obligimin ndërkombëtar për të hyrë në dialogun ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe të Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, që nga viti 2011, duke respektuar Rezolutën së Asamblesë së

Përgjithshme të OKB-së, A/RES/64/298 të datës 9 shtator 2010 dhe në përputhje me kompetencat kushtetuese të Qeverisë për të ushtruar sovranitetin shtetëror në politikën e jashtme të vendit sipas nenit 93, pika 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes rezolutave të saja.

### **1.1. Dialogu i Brukselit në dobi të shtetit të Kosovës**

Qeveria njih dhe vlerëson lartë rezultatet e deritashme të arritura në Dialogun e Brukselit që janë në dobi të shtetit të Kosovës. Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve të datës 19 prill 2013 të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Marrëveshjet e Brukselit të Dialogut teknik (2011-2012) kanë kontribuar dukshëm në forcimin e shtetit të Kosovës, në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, duke ndihmuar në konsolidimin e sovranitetit në tërë territorin e Kosovës si dhe duke avancuar rrugën e Kosovës në integrimet evropiane dhe euro-atlantike.

Dialogu i Brukselit, në planin e brendshëm, ka kontribuar në shtrirjen e sovranitetit shtetëror të Kosovës në pjesën veriore të vendit, përmes shuarjes së strukturave paralele të Serbisë në Kosovë në fushat ku janë arritur marrëveshjet dhe integrimin të individëve të komunitetit serb (ish-personelit të këtyre strukturave) në institucionet e shtetit të Kosovës. Po ashtu, ky dialog ka mundur vendosjen e kufirit ndërshtetëror mes Kosovës dhe Serbisë dhe vendosjen e autoriteteve shtetërore të Kosovës në dy pikëkalimet kufitare në pjesën veriore të kufirit, të cilat ishin të cenuara nga Serbia pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008.

Në planin ndërkombëtar, Dialogu i Brukselit ka kontribuar në fuqizimin e ardhmërisë euro-atlantike të Kosovës, duke ndihmuar në avancimin e anëtarësimeve të Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe rajonale, rritjen e numrit të njohjeve, përmirësimin e imazhit të shtetit të Kosovës në botë, rrjedhimisht duke forcuar dëshmitë se pavarësia e Kosovës është faktor për paqëje dhe stabilitet në rajon dhe ma gjerë.

Po aq e rëndësishme, Dialogu i Brukselit ka kontribuar drejtpërdrejtë në perspektivat e hyrjes zyrtare të vendit tonë në rrugën e integritit evropian, nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, me shumë gjasa që të nënshkruhet në të ardhmen e afërt. Kjo do të shënojë një hap historik drejt së ardhmes evropiane të Kosovës. Qeveria e Kosovës vazhdimisht ka kërkuar nga BE-ja që Kosova të shpërblehet për konstruktivitetin e saj në dialogun e Brukselit duke e marrë MSA-në me BE-në dhe një kërkesë e tillë tashmë është në prag të realizimit.

Qeveria po ashtu vlerëson lartë përpjekjet e BE-së për të kushtëzuar rrugën e Serbisë në integrimi evropian me normalizimin e plotë të marrëdhënieve me shtetin e Kosovës duke vendosur kapitullin 35 si një kusht shtesë. Me kapitullin 35, Serbia do të obligohet për zbatim të plotë të marrëveshjeve të Brukselit dhe për arritjen e një marrëveshje ndërkombëtare juridikisht të obligueshme. Një kushtëzim i tillë ndaj Serbisë, që pritet të miratohet në një të ardhme të afërt, ka ardhur si rezultat i punës së Qeverisë së Kosovës e cila ka arritur të ofroj dëshmi faktike për dështimet e Serbisë në përmbushjen e obligimeve për zbatimin e marrëveshjeve të arritura me Kosovën. Për këtë qëllim, Qeveria e Kosovës ka paraqitur para Bashkimit Evropian raporte të rregullta mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit.

Qeveria konsideron se në saje të këtij procesi intensiv paqësorë katër vjeçar, me ndërmjetësimin konsekuent nga ana e Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e plotë nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, me një të kaluar armiqësore janë duke u transformuar në një model evropian të bashkëpunimit. Qeveria konsideron se dialogu i Brukselit ka vendosur bazat për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore mes dy shteteve dhe se ky proces duhet të përfundoj me njohjen e ndërsjellë mes dy shteteve.

## **1.2. Njohja e ndërsjellë mes dy shteteve sjellë paqe të qëndrueshme në rajon**

Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se vetëm njohja reciproke mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, me garancitë e SHBA-ve dhe BE-së, do të sjellë paqe dhe normalizim të qëndrueshëm të marrëdhënieve fqinjësore mes dy shteteve si dhe për paqen dhe stabilitetin e qëndrueshëm në rajon. Kjo do të ishte një marrëveshje historike për të mbyllur kapitullin e armiqësive dhe për të hapur kapitullin e paqes mes dy shteteve dhe madje edhe mes dy kombeve, shqiptarëve dhe serbëve.

Qeveria e Kosovës konsideron se njohja reciproke mes dyja shteteve duhet të ndodh para pranimit të tyre në Bashkimin Evropian, qëndrim ky që duhet të mbështetet nga të gjitha vendet e anëtare të Bashkimit Evropian, me qëllim të sigurimit të paqes së qëndrueshëm në rajon dhe Evropë.

Qeveria e Kosovës konsideron se dialogu i Brukselit është një prej standardeve evropiane për fqinjësinë e mirë të cilin dyja shtetet duhet ta plotësojnë në rrugëtimin e tyre për Bashkimin Evropian.

Vlen të theksohet se Dialogut të Brukselit i kanë paraprirë dy proceseve paqësore të mëhershme që Kosova ka zhvilluar me shtetin fqinjë Serbinë, me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare. Konferenca paqësore e Rambujesë më 1999 i dha fund

luftës në Kosovë dhe hapi rrugën për çlirimin e Kosovës, ndërsa bisedimet e Vjenës ër statusin hapën rrugën e pavarësisë së Kosovës. Kosova ka dalë fitimtare nga të dy proceset e paqes, ndërsa Serbia dështoi me mosnënshkrimin e marrëveshjeve. Dialogu i Brukselit duhet të rezultojë me njohjen reciproke midis dy shteteve që do të hapin rrugën për një ardhmëri paqësore dhe evropiane për të dyja shtetet.

### **1.3. Marrëveshjet e Brukselit dhe përfitimet për Kosovën**

**Marrëveshjet e Dialogut Teknik**, gjithsejtë shtatë, janë marrëveshjet e para të arritura dhe nënshkruara në historinë mes dy shteteve, me ndërmjetësimin e BE-së dhe pjesëmarrjen e SHBA-ve në tryezën bisedimeve. Këto marrëveshje kanë vënë bazat e reciprocitetit ndërshtetëror në bashkëpunimin mes dyja vendeve në fusha të rëndësishme. Marrëveshjet e dialogut teknik përfshijnë këto fusha: njohja e ndërsjellë e dokumenteve shtetërore dhe lëvizja e lirë (Marrëveshja për lëvizjen e lirë); njohja e kufirit ndërshtetëror dhe vendosja e bashkëpunimit kufitar (Marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit/Marrëveshja e IBM-së dhe Protokollit teknik); tregtia e lirë dhe njohja e ndërsjellë e vulave doganore (Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të vulave doganore); njohja e ndërsjellë të diplomave universitare (Marrëveshja për diploma); Marrëveshja për kthimin e plotë të regjistrave civil të Kosovës të marra dhunshëm nga Serbia gjatë luftës së Kosovës (dokumente origjinale të skanuara dhe vërtetuar nga BE) që tashmë është zbatuar në tërësi; Marrëveshja për kthimin e dokumentacionit kadastral të Kosovës të marrë dhunshëm nga Serbia në periudhën e luftës dhe marrëveshja për heqjen e pengesave për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e shtetit të Kosovës në organizata rajonale (Marrëveshja për Përfaqësim dhe Bashkëpunimin rajonal), e cila ka mundur që Kosova të bëhet anëtare e të gjitha organizatave relevante rajonale. Po ashtu, nga Dialogu teknik kanë dalë draft marrëveshjet për çështjet e telekomunikacionit dhe energjisë që janë finalizuar gjatë dialogut për normalizim.

**Marrëveshja e Brukselit për Normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore mes dy shteteve**, e nënshkruar nga kryeministrat e të dyja shteteve dhe përfaqësuese së lartë të BE-së, më 19 prill 2013 në Bruksel, me ndërmjetësimin e BE-së, është vlerësuar nga bashkësia ndërkombëtare si një marrëveshje historike sepse ka vënë bazat e fqinjësisë së mirë mes të dyja shteteve sipas parimeve evropiane. Kjo marrëveshje ka përcaktuar obligime ndërkombëtare në aspekte shumë të rëndësishme siç janë: funksionimit legal dhe integrimi në fushat e sigurisë, drejtësisë, të funksionimit legal të komunave dhe rrjedhimisht të një procesi integruar të qytetarëve serb të pjesës veriore në institucionet e shtetit të Kosovës, shuarjen e strukturave ilegale serbe, të vendosjes së ligjit në

grumbullimin e taksave doganore e përparime tjera. Në planin ndërkombëtar, kjo marrëveshje ka sanksionuar zotimin e të dyja shteteve për të mos penguar njëra tjetrën në rrugën e tyre të integritit evropian. Në funksion të krijimit të mirëbesimit dhe integritit të pjesëtareve të komunitetit serb në institucionet shtetërore të Kosovës, Qeveria ka krijuar një Fond për zhvillim për komunat veriore dhe iniciuar Ligjin për amnistinë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Është me rëndësi të theksohet se në të gjitha fushatë ku janë arritur marrëveshjet e Brukselit, Serbia ka njohur pavarësinë e Kosovës, sepse marrëveshjet janë bazuar në juridikcionet e veçanta të secilit shtet dhe kanë qenë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

#### **1.4. Procesi i zbatimit të marrëveshjeve**

Në përgjithësi, Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se ka pasur progres të konsiderueshëm në zbatimin e marrëveshjeve të dialogut të Brukselit gjatë periudhës së kaluar. Progresi në procesin e zbatimit është i nivele të ndryshme për fushat të ndryshme ku janë arritur marrëveshjet. Progres i mirë është arritur në çështjet e funksionimit ligjor dhe demokratik të katër komunave veriore, çështjet e sigurisë për pjesën e policisë, IBM-i, liria e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, librat e regjistrimit civil, e cila është përfunduar, mbledhja të hyrave doganore, të Fondit të zhvillimit, në energji marrëveshjet e zbatimit të energjisë, përfaqësim dhe bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal.

Megjithatë, ka nevojë një progres ma substancial për të finalizuar proceset e zbatimit në çështjet e drejtësisë, ku tashmë plani për zbatim është dakorduar; në çështjet e sigurisë për pjesën e shuarjes së të ashtuquajturës "struktura të mbrojtjes civile serbe" ku nuk ka përparime në zbatim; në telekomunikacion përkatësisht kodin telefonik për Kosovën që do të jetë 383 ku marrëveshja për zbatim ende nuk është nënshkruar, në fushën e sigurimit të automjeteve ku pritet së shpejti të nënshkruhet marrëveshja për njohjen reciproke të kartonit të sigurimit të automjeteve mes dy shteteve, në planin për zbatim të marrëveshjes për Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë, zbatimi i marrëveshjes së heqjes së barrikadës nga Ura e Ibrit dhe të tjerave që kanë mbetur, nga ana e BE-së. Ndërkaq, marrëveshjet për njohjen reciproke të diplomave universitare dhe dokumenteve kadastralë janë në pritje të zbatimit.

Më hollësisht, gjendja e fundit në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit është paraqitur në raportin e fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën Janar – Shtator 2014, të dorëzuar në BE më 10 tetor 2014. Ndërsa, në përgjithësi procesi i zbatimit të marrëveshjeve, prej fillimit të Dialogut të Brukselit më 8 mars 2011 deri në kohën e

hartimit të këtij programi, është i pasqyruar në raportet periodike të Qeverisë së Kosovës të paraqitura në Bashkimin Evropian, të cilat janë të publikuara në webfaqen zyrtare të ZKM-së.

Qeveria duke qenë e vetëdijshme se shumë punë mbeten për tu bërë në të ardhmen, do të angazhohet fuqishëm për zbatimin e plotë dhe efektiv të Marrëveshjes së Brukselit për Normalizim dhe Marrëveshjeve të dala nga Dialogu Teknik si dhe për arritjen e marrëveshjeve të reja në fusha me interes për vendin sipas parimeve të reciprocitetit në bashkëpunime bilaterale mes dy shteteve.

Qeveria shpreh bindjen e thellë se çelësi i suksesit të Dialogut të Brukselit është te zbatimi i plotë dhe efektiv i të gjitha marrëveshjeve, të cilën Kosova e ka dëshmuar duke përmbushur me konsekuencë obligimet e saja zbatuese. Qeveria vlerëson se mungesa e vullnetit politik të Serbisë për fqinjësi të mirë dhe marrëdhënie evropiane me shtetin e Kosovës, ka qenë faktori kryesor për moszbatimin, zvarritjet dhe herë herë shkeljen e marrëveshjeve nga ana e Serbisë, për të cilat Qeveria në vazhdimësi ka kërkuar dhe kërkon angazhim më të fuqishëm të Bashkimit Evropian si ndërmjetëse dhe garantuese e këtij procesi.

#### **1.5. Objektivi kryesor për periudhën vijuese - njohja e ndërsjellë mes dy shteteve**

Në periudhën vijuese, Qeveria e Republikës së Kosovës angazhimet e saja do ti përqendroj në disa nivele të këtij procesi, siç janë: zbatimi i plotë dhe efektiv i marrëveshjeve që janë në pritje të zbatimit, zgjidhja e çështjeve të mbetura dhe arritja e marrëveshjeve të reja.

Sa i takon zbatimin të marrëveshjeve, Qeveria do të kërkoj nga Bashkimi Evropian angazhime shtesë në këtë drejtim.

Në kuadër të çështjeve të mbetura, Qeveria do ti jep prioritet çështjeve të drejtësisë, sigurisë / shuarjen e strukturës ilegale të ashtuquajtur "mbrojtja civile" , telekomunikacionit / kodit telefonik shtetëror 383, energjisë, asociacionit, etj.

Për sa i takon temave për fazën përfundimtare të Dialogut të Brukselit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka formuluar pozicionin e sajë dhe ia ka bërë të njohur Bashkimit Evropian se dialogu i Brukselit duhet të përmbillet me njohjen e ndërsjellë mes dy shteteve në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Ky qëndrim është i shprehur në Dokumentin mbi temat në fazën vijuese, të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës e ka parashtruar në Bashkimin Evropian në mars të 2014. Në këtë dokument, të mbështetur në parimet e të drejtës ndërkombëtare për fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim



mes dy shtetesh të cilat kanë pasur një luftë në mes vete, përfshihen të gjitha çështjet me interes për vendin tonë siç janë: njohja e ndërsjellë mes të dyja shteteve, çështjet e reparacionit të luftës që nga të pagjeturit dhe dhunimet e grave gjatë luftës, kthimi i pensioneve dhe depozitat bankare, kthimi i artifakteve dhe arkivave, deri te kompensimet e dëmeve të luftës, çështja e suksesionit përkatësisht ndarja e pasurisë mes dy shteteve të trashëguar nga ish-Jugosllavia dhe demarkacioni i kufirit mes Kosovës dhe Serbisë.

### **1.6. Roli i faktorit ndërkombëtar garanci për sukses**

Qeveria do të mbetet e përkushtuar për Dialogun e Brukselit dhe zbatimin e marrëveshjeve, përderisa thekson se roli faktorit ndërkombëtar është garanci për sukses.

Qeveria kërkon nga Bashkimi Evropian një angazhim më të fuqishëm për ta detyruar Serbinë që të përmbush obligimet zbatuese të tashme dhe ato që do të vijnë nga marrëveshjet e ardhshme.

Qeveria do të vazhdoj të bashkëpunoj ngushtë me partnerët strategjik, SHBA-të dhe BE-në dhe vendet e anëtare të saj, në veçanti Gjermaninë, si dhe gjithë vendet tjera përkrahëse për një përfundim të suksesshëm të këtij procesi paqësor me rëndësi për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe rajonale.

## **2. DIALOGU DHE DIPLOMACIA PËR FUQIZIMIN NDËRKOMBËTAR TË KOSOVËS**

Duke marrë parasysh se bashkësia ndërkombëtare i jep rëndësi të madhe Dialogut të Brukselit si një proces në funksion të paqes dhe sigurisë në rajon, dhe madje ky dialog gjithnjë e më shumë shihet si një model pozitiv për të zgjidhur çështjet e hapura mes vendeve të rajonit e më gjerë, roli konstruktiv i Kosovës në këtë proces i vlerësuar ndërkombëtarisht është një aset i çmuar, një argument i fuqishëm që Qeveria e Kosovës do të vazhdoj ta shfrytëzojë në diplomaci në favor të forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës.

Në planin diplomatik, Qeveria do të vazhdoj të lobizojë në planin bilateral dhe multilateral për të ndriçuar rolin konstruktiv të Kosovës në dialogun e Brukselit duke kërkuar që konstruktiviteti i Kosovës të shpërblehet me qartësinë më të madhe të ardhmërisë evropiane të Kosovës dhe përshpejtimin e integritimit evropian dhe euro-atlantik të Kosovës. Si cak i lobimeve do të jenë sidomos pesë vendet anëtare të

Bashkimit Evropian të cila ende nuk e kanë njohur Kosovën, që sa më shpejtë ta njohin shtetin e Kosovës, në të mirë të paqes dhe stabilitetit në rajon. Diplomacia në mbështetje të dialogut do të shërbejë jo vetëm për vet suksesin e dialogut por edhe në rritjen e numrin të njohjeve dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe rajonale duke përfshirë BE, NATO, OKB-në

### **3. STRATEGJIA E DIALOGUT**

Qeveria e Republikës së Kosovës do të zhvilloj një strategji për negociim duke u bazuar në Dokumentin për Strategjinë Nacionale për Dialogun e Brukselit të vitit 2011, që ka për bazë teoritë relevante dhe praktikën e avancuar të negociatave ndërkombëtare si dhe përcakton zonat e mundshme të gjetjes së zgjidhjeve duke respektuar në mënyrë rigorozë vijat e kuqe të dialogut në respektim të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pacenueshmërinë e sovranitetit dhe integritetit territorial dhe rregullimit të brendshëm të shtetit të Kosovës, dhe në çështjet e minoriteteve respektimin e Planit Ahtisarit.

### **4. PARIMET THEMELORE DHE PARIMET E PANEGOCIUESHME TË DIALOGUT**

Qeveria e Republikës së Kosovës në dialogun e Brukselit, si edhe deri më tani, do të respektojë parimet themelore dhe parimet e panegociueshme, si në vijim:

#### **4.1. Parimet themelore**

1. Dialogu i Brukselit do të përfshijë vetëm çështjet e interesit të ndërsjellë mes dy shteteve, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e shtetit të Kosovës, pavarësinë, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetutës të Kosovës
2. Të gjitha marrëveshjet e arritura kanë qenë dhe do të jenë në pajtim të plotë me Kushtetutën së Republikës së Kosovës dhe ligjet e vendit
3. Respektimi i të drejtës ndërkombëtare dhe standardeve euro-atlantike për fqinjësi të mirë mes shtetesh që kanë pasur një histori lufte të shkaktuar nga agresioni i Serbisë në Kosovë
4. Njohja e ndërsjellë mes dy shteteve

5. Respektimi i ndërsjellë i sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial mes dy shteteve
6. Mosndërhyrja në sovranitetin e njëra tjetrës dhe zhbërja e plotë e gjithë strukturave të mbetura paralele /ilegale të Serbisë në Kosovë
7. Respektimi i kufirit ndërshtetëror mes dy shteteve
8. Vendosja e bashkëpunimit ndërshtetëror në fusha me interes të ndërsjellë sipas standardeve evropiane dhe euroatlantike
9. Zgjidhja e çështjeve të reparacioneve të luftës dhe suksesionit në bazë të drejtës ndërkombëtare
10. Respektimi i ndërsjellë i të drejtave të minoriteteve në të dyja shtetet

#### **4.2. Parimet e panegociueshme / vijat e kuqe**

Qeveria e Republikës së Kosovës nuk do të shkel në asnjë rast parimet e panegociueshme, sepse ato i konsideron vija të kuqe që nuk guxojnë të shkelen, siç janë:

1. Statusi i Kosovës është i zgjidhur. Kosova është shtet i pavarur, sovran me integritet territorial të paprekshëm dhe kushtetutë moderne të njohur ndërkombëtarisht. Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi ka konfirmuar ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës më 22 korrik 2010. Shteti i Kosovës është njohur nga pjesa më e fuqishme e bashkësisë ndërkombëtare, nga 75 shtete në mesin e të cilëve SHBA, shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, shtetet e rajonit e më gjerë. Kosova është anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe procesi i njohjeve është në rritje.
2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.
3. Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore, e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

4. Plani i Ahtisarit është platforma për rregullimin e të drejtave dhe garancive për komunitetet dhe i njëjti është integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Plani i Ahtisarit ofron kompetenca të veçanta për komunitetin serb, dhe si i tillë madje është më shumë se që ofron e drejta ndërkombëtare për minoritetet.

## **5. FUSHËVEPRIMTARIA E DIALOGUT TË BRUKSELIT**

Pushë veprimtaria e dialogut të Brukselit përfshinë angazhimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për bisedime ndërkombëtare paqësore që kanë për qëllim vendosjen e marrëdhënieve ndër fqinjësore mes dy shteteve, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e fuqishme të SHBA-ve.

Në periudhën e kaluar, marrëveshjet e arritura kanë prodhuar rezultate mjaft të rëndësishme për Kosovën, në drejtim të shtrirjes së sovranitetit shtetëror në pjesën veriore të vendit, zhbërjes së strukturave paralele serbe, ndaljes së ndërhyrjeve të Serbisë, rritjes së integritetit të pjestarëve të komunitetit serb në institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, vendosjen e bashkëpunimit ndërshtetëror mbi parime reciprociteti mes dy shteteve, si dhe në avancimin e integritetit evropian dhe euro-talantik të Kosovës ku kontributi i Dialogut të Brukselit ka qenë i drejtpërdrejtë.

Në periudhën e ardhshme, Dialogu i Brukselit për fqinjësi do të hyjë në fazën përmbyllëse dhe qëndrimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që ky dialog duhet të përfundoj me njohjen reciproke mes dy shteteve, në funksion të paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon dhe të integritetit evropian të dyja shteteve duke marrë parasysh se fqinjësia e mirë është një prej kriterëve kryesorë për integritetin evropian të shteteve aspirante. Në këtë fazë përmbyllëse, do të adresohen çështja njohjes së ndërsjellë mes dy shteteve, demarkacioni kufirit, çështjet që lidhen me reparacionet e luftës të shkaktuara nga lufta agresore dhe gjenocidale e Serbisë ndaj Kosovës dhe çështjet e suksesionit.

Procesi i dialogut ka qenë përgjegjës dhe është realizuar nga Zëvendëskryeministrja për çështje të politikës së jashtme dhe sigurisë nacionale, Dr. Edita Tahiri, njëherësh Udhëheqëse e delegacionit dhe Kryenegociatore e Republikës së Kosovës në Dialogun e Brukselit.

Në këtë mandat qeveritar, udhëheqësja e delegacionit dhe Kryenegociatorja Edita Tahiri udhëheq këtë proces në postin e Ministres të ngarkuar për dialog.

Kryenegociatorja dhe udhëheqësja e delegacionit të Republikës së Kosovës në Dialogun e Brukselit ka ushtruar përgjegjësit dhe detyrat e udhëheqjes së procesit të dialogut, që përfshinë negociimin e marrëveshjeve në Bruksel, përgatitjen e platformave dhe strategjive për negociata, për dialogun në përgjithësi dhe për temat e diskutuara në veçanti.

Veprimtaria e Kryenegociatores është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Kryeministrin, Qeverinë dhe Ministrinë e linjës varësisht nga temat që trajtohen në dialogun e Brukselit. Ekipi i dialogut në mbështetje të punës së Kryenegociatores përbëhet nga antarët e kabintetit të sajë, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Planifikim Strategjik e ZKM-së si dhe ekspertët nga ministrit dhe agjencitë publike të caktuar nga ana e ministrave dhe udhëheqëseve të agjencive.

Në dokumentin e Platformës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun Teknik të vitit 2011 janë të përkufizuara kompetencat, organizimi strukturor dhe vendimmarrja në procesin e dialogut. Po ashtu parashihen konsultat dhe raportimet të Presidentit dhe raportimet e rregullta në Kuvendin e Kosovës. Njëkohësisht, janë përkufizuar edhe raportet me opozitën dhe shoqërinë civile sipas parimit të gjithë përfshirjes si dhe angazhimi i ekspertëve ndërkombëtar. Kjo strukturë ka funksionuar mjaft mirë, gjë e cila mund të shihet nga rezultatet e konsiderueshme të dialogut në favorin e shtetit tonë.

Në periudhën e dialogut teknik, 2011-2012, dialogu në Bruksel është zhvilluar në nivelin e kryenegociatorëve të dyja shteteve, Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe SHBA-ve.

Në periudhën e dialogut për normalizim të marrëdhënieve, 2012-2014, dialogu i Brukselit është ngritur në nivelin e Kryeministrave të dyja shteteve me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe rolin mbështetës të SHBA-ve. Kryeministri Hashim Thaçi ka udhëhequr delegacionin e Republikës së Kosovës, pjesë e të cilit ka qenë Zëvendëskryeministrja dhe Kryenegociatorja Edita Tahiri. Në këtë periudhë, marrëveshja kornizë, e njohur si Marrëveshja për normalizim të marrëdhënieve e datës 19 prill 2017 dhe Plani për implementim, që pëfshinë një numër çështjesh të veçanta, është negociuar dhe arritur në nivel të kryeministrave. Marrëveshjet për çështjet e veçanta që derivojnë nga ajo, janë negociuar dhe arritur në nivelin e kryenegociatorëve të dyja shteteve.

Dialogu është një proces mjaft i ndjeshëm dhe dinamik, që ngërthen në vete numër të madh variablash ( çështjesh, nënçështjesh,.., etj.) brenda fushave të diskutuara, që krijon vështirësi në transferin e të gjithë procesit tek aktorët e ri, aq më shumë që

negociatat shoqërohen me konfidencialitet, që është një faktor qenësor për suksesin e tij. Kështu, derisa numri i marrëveshjeve të arritura ka mbërrirë rreth 20, së bashku me planet për zbatim (që janë po ashtu marrëveshje të negociuara dhe dakorduara) dhe marrëveshje për nën çështjet që derivojnë nga marrëveshjet apo planet për zbatime, numri i përgjithshëm i marrëveshjeve mbërrin mbi 50 sosh. Në fakt ky proces në mënyrë metaforike mund të shihet si një piramidë ku në krye të piramidës janë marrëveshjet bazë, piramida vazhdimisht vjenë e zgjerohet me marrëveshjet për implementim dhe marrëveshjet për nënçështjet që derivojnë nga të parat.

Me një shpjegim tjetër, vendosja e një bashkëpunimi ndërshtetëror me Serbinë sipas standardeve evropiane dhe shuarja strukturave ilegale serbe që kanë vepruar ilegalisht në Kosovë që nga viti 1999, në kushtet e mosnjohjes reciproke, nxjerrë pengesa të natyrave të ndryshme politike, dhe për secilën prej tyre duhet të gjendet zgjidhja për të bërë që marrëveshja të funksionoj. Vlenë të theksohet që gjatë procesit të zbatimit paraqiten shkelje të formave të ndryshme nga ana e Serbisë që kërkojnë trajtim shtesë për të evituar problemet. Më tej, për gjithë këto shkelje duhet raportuar në Bashkimin Evropian, sepse siç dihet Serbia është e kushtëzuar me zbatimin e marrëveshjeve në rrugën e sajë evropiane përmes kapitullit 35.

Nëse shtrohet pyetja se si ka qenë e mundur të përballohen gjithë këto detyra dhe përgjegjësi, mund tju them me përgjegjësi të plotë se të gjithë zyrtarët që kanë qenë të angazhuar në këtë proces, kanë treguar performanca të larta, përkushtim shtetëror dhe punë pa orar. Mirëpo, një dinamikë e tillë nuk mund të përballohet më tej, kërkojnë kushte më të mira, si për nga rritja e numrit të stafit, ashtu edhe pagesa për punë jashtë orarit, e paraparë me ligjet e vendit.

## **6. KATËR SHTYLLAT E PROCESIT NEGOCIATOR**

Fushëveprimtaria e dialogut ka katër shtylla kryesore, siç janë: 1. Negocimi i marrëveshjeve, 2. Zbatimi dhe monitorimi, 3. ligjshmëria e procesit, 4. Ndërlidhja e dialogut me agjendën evropiane të Kosovës

### **1. Negocimi**

- Përgatitja e Agjendës për prioritetet e Qeverisë në Dialogun e Brukselit
- Negocimi me BE-në që këto çështje të përfshihen në Agjendën e dialogut të Brukselit
- Përgatitja e platformës dhe strategjisë për negociatat në dialogun e Brukselit në përgjithësi dhe për temat e caktuara në veçanti

- Negocimi dhe arritja e marrëveshjeve mes dy shteteve, me ndërmjetësimin e BE-së

## **2. Zbatimi dhe Monitorimi**

- Negocimi i marrëveshjeve për zbatim/ planeve për zbatimin të marrëveshjeve të arritura, që përfshinë përgatitjen e platformës dhe strategjisë për negociata për zbatimin dhe procesin e bisedimeve në dialogun e Brukselit
- Zbatimi i marrëveshjeve dhe planeve për zbatim në përmbushje të obligimeve zbatuese të palës tonë, në bashkëpunim me dikasteret e qeverisë dhe agjencionet kompetente publike
- Monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve, që përfshinë përcjelljen e gjendjes në zbatim, të shkeljes së marrëveshjes dhe afateve të parapara në planin për zbatim nga pala serbe, të cilësisë së zbatimit dhe
- Raportimi në Bruksel për këto shkelje me qëllim të evitimit të tyre, duke kërkuar që BE-ja të marrë masa që ta detyroj Serbia për të zbatuar marrëveshjet

## **3. Ligjshmëria e procesit**

- Procesi i negociatave dhe marrëveshjet e arritura duhet të jenë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Ligjet e Kosovës, që realizohet përmes procesit të këshillimeve dhe verifikimeve ligjore

## **4. Ndërlidhja me Agjendën evropiane të Kosovës**

- Raportimi i rregullt në BE për gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve, në mënyrë periodike dhe në baza ditore, sipas dinamikave të shkeljeve të marrëveshjeve dhe planeve për zbatim, për të njoftuar dhe kërkuar angazhimin e BE-së për zgjidhjen e këtyre problemeve
- Ndërlidhja e avancimeve në integritet evropian për Kosovën, duke ndriçuar performancat e palës së Kosovës në dialog dhe kërkesa që BE-ja ta vlerësoj dhe përkthej në shpërblim për avancimin e shtetit tonë në integritetin evropian.
- Raporti për progresin në dialog të jetë i përfshirë në mënyrë reale në Raportin e progresit të BE për Kosovën
- Përcjellja e procesit të negociatave për anëtarësimi të Serbisë, në kuadër të kushtëzimit të sajë me Dialogun e Brukselit dhe në veçanti kapitullin 35, duke vënë në dijeni BE-në për shkeljet e Marrëveshjeve

## **7. SHTIMI I KAPACITETEVE**

Për të përballuar me sukses agjendën në rritje dhe sfidat komplekse të këtij dialogu, ato ekzistuese dhe të tjerat që do të vijnë, kërkohet shtimi i kapaciteteve të mekanizmit/ekipit të dialogut. Ky shtim i kapaciteteve nënkupton konsolidimin e Ministrisë për Dialog, në kuptimin krijimit të stafit administrativ në mbështetje të punës së Ministres për Dialog e cila disponon vetëm me kabinetin politik të sajë.

Qeveria duhet të angazhohet për shtimin e kapaciteteve institucionale në këtë sektor për këto arsye: për faktin se Dialogu i Brukselit është një prej kushteve kryesore për integrimin evropian të dyja shteteve; marrë parasysh agjendën e sajë progresive si për nga çështjet e trajtuara dhe të tjerat që priten të jenë në agjendë, për arsye se kohëzgjatja dhe vijimësia që pritet të jetë e shtigjeve të gjata mbase deri në anëtarësimin e të dyja shteteve në Bashkimin Evropian. Së këndejmi, është e domosdoshme dhe me interes të ketë një strukturë të qëndrueshme, përkatësisht krijimin e një stafi administrativ mbështetës të nivelit politik, që do të mund të funksiononte si një ministri për dialog.

Konsolidimi i Ministrisë avancoon qëllimet institucionale për funksionimin më cilësor, kontinuitetin, memorien institucionale dhe shfrytëzimin e ekspertizës së fituar, që për periudhën e ardhshme mund të evitojë pasojat e ndryshimeve politike/qeveritare të cilat kanë krijuar humbjen e kuadrove të dialogut.

Krahas Ministrisë për dialogun duhet të krijohet dhe një Komitet ndërministror për funksionalizimin e katër komunave veriore sipas ligjeve të Kosovës. Si rezultat i Dialogut të Brukselit, këto komuna kanë marrë pjesë në zgjedhjeve lokale 2013 dhe kanë hyrë një proces të funksionalizimit legal dhe demokratik me konstituimin e organeve legale komunale dhe miratimin e statuteve konform ligjeve të Kosovës. Komisioni Ndërministror do të ishte një mekanizëm për funksionalizimin e plotë ligjor të këtyre komunave dhe integrimin e plotë në sistemin shtetëror të Kosovës.

## **8. BUXHETI PËR DIALOG**

Buxheti për dialog në periudhën e kaluar ka qenë i mbuluar nga ZKM, nuk ka pasur një buxhet të veçantë, përveç për vitin 2011. Përderisa mbështetja nga ZKM dhe vet KM ka qenë e plotë, ky buxhet ka mbuluar vetëm udhëtimet në Bruksel për stafin politik dhe civil të ZKM-së, ndërsa Ministrinë dhe Agjencinë kanë marrë përsipër financimin e stafit të tyre përkatës. Në proces janë vërejtur mangësi dhe kufizime në këtë model buxhetimi, duke qenë se ministrinë dhe agjencinë të caktuara kohë pas kohe nuk kanë mundur të marrin pjesë në bisedime për shkak të mungesës së buxhetit për të cilën nuk



kanë pasur linja buxhetore. Po ashtu, mangësitë tjera kanë qenë të lidhura me moskompensimin e punës shtesë, duke qenë se para dhe gjatë bisedimeve të Brukselit punohet përtej orarit të punës, duke përfshirë përgatitjen e platformave dhe strategjive për negociim, ndërsa vet procesi i negociatave në Bruksel zhvillohet deri në orët e vona të natës në shumë raste.

## 9. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Teoria dhe praktika negociatore sugjerojnë se për të qenë negociatat e suksesshme, kërkohet respektim të një shkalle të konfidencialitetit në këtë proces. Konfidencialiteti lidhet me vet ndjeshmërinë e procesit dhe që natyrisht pamundëson transparencën e plotë. Në periudhën e kaluar jemi angazhuar që të gjejmë një balancë të komunikimit publik mes kërkesave të qytetarëve, mediave, opinionit publik dhe shoqërisë civile në një anë dhe respektimit e parimit të konfidencialitetit në anën tjetër. Komunikimi me publikun është realizuar në forma të ndryshme, bashkëpunimi me mediat dhe hulumtuesit në këtë fushë, publikimi i marrëveshjeve në Website-in e ZKM, konferencat për shtyp pas çdo raundi dhe pas çdo marrëveshje, intervistat, pjesëmarrja në tryeza e konferenca vendore e ndërkombëtare, etj. Në fazën vijuese, mendoj se transparenca duhet të rritet por me kujdes, jo pse opinionin nuk duhet të njoftohet plotësisht, por sepse negociimi i një marrëveshjeje është një proces që ndryshon dhe avancohet ndërsa për opinion valid janë rezultatet përfundimtare/marrëveshjet e arritura. Rritja e transparencës mund të realizohet duke vazhduar traditat e bashkëpunimit si dhe duke e pasuruar më tej, siç mund të jetë: duke hapur një website për dialogun, botimi i publikimeve për të dy fazat e dialogut, teknik dhe për normalizim, botimi i broshurave udhëzuese për qytetarët për të shfrytëzuar më mirë shërbimet që i ofrojnë marrëveshjet, etj.

Në aspektin e llogaridhënies duhet të vazhdojnë raportimet e rregullta në Kuvendin e Kosovës në bazë të parimeve të përcaktuara në Rezolutat e Kuvendit. Ky obligim mund të shtrihet më tej në takime me qytetarët në bashkëpunim me Kuvendet komunale dhe forma tjera për komunikim.



Edita Tahiri  
Ministre për dialog  
Kryenegociatore në Dialogun e Brukselit